



**PROGRAMORIENTUES  
PËR TESTIMINE INFORMUATIZUAR “  
MËSUES PËR SHQIPËRINË”  
2024**

---

**LËNDA  
MATEMATIKË**



# TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
HYRJE.....	2
QËLLIMI I PROGRAMIT.....	3
PËRMBAJTJA E PROGRAMIT.....	4
FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE.....	4
FUSHA: PROGRAME LËNDORE.....	6
FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK- UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE.....	7
FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT.....	10
FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE.....	10
FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS.....	11



# HYRJE

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” të lëndës së matematikës është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve që duan të ushtrojnë profesionin e mësuesit në lëndën e matematikës. Ky program përfaqëson dhe përmbush, njëherazi, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesit dhe përgatitjen për testimin e formimit të përgjithshëm dhe shkencor të kandidatit.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MAS-i ka vendosur për kandidatët që testohen. Programi përcakton njohuritë dhe aftësitë kryesore sipas fushave të mëposhtme:

- a) Dokumente zyrtare<sup>1</sup> të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore - edukative të mësuesve.
- b) Programe lëndore të matematikës.
- c) Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënien e lëndës së matematikës.
- d) Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- e) Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- f) Përmbajtja shkencore sipas programeve lëndore të matematikës.

---

<sup>1</sup>Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS-it që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.



# QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e informatizuar “Mësues për Shqipërinë” të lëndës së matematikës është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të kandidatëve. Ai ofrohet si një program orientues për t’u ardhur në ndihmë të gjithë kandidatëve dhe mësuesve të lëndës së matematikës në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese.

Programi synon:

- rritjen e përgjegjshmërisë së kandidatëve dhe të mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore.
- rritjen e kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejt në efektivitetin e procesit mësimor.
- rritjen e aftësive në fushën pedagogjike për mësimdhënie strategjike, për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave për vlerësimin e nxënësve etj.
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë.
- rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes.
- demonstrimin konkret të aftësive shkencore dhe kompetencave të fituara, në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.



# PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për testimin e kandidatëve të matematikës është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, përpos kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së matematikës. Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë kandidatin (mësuesin) që të identifikojë nevojat e tij, si dhe për çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për **secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet** që priten të zotërojë mësuesi në fushën e njohurive dhe aftësive, **si dhe literatura përkatëse rekomanduese** që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

## FUSHA: DOKUMENTE ZYRTARE

<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe të dokumentacionit shkollor”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<b>Rezultatet e pritshme</b> <i>Mësuesi i matematikës:</i> <ul style="list-style-type: none"><li>- zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar;</li><li>- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore;</li><li>- zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës;</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</li><li>- Urdhër Nr. 31 datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.</li><li>- Udhëzimi nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit</li></ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MAS-it në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies; nxënies;</li> <li>- zbaton etikën profesionale të mësuesit;</li> <li>- respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit;</li> <li>- respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit;</li> <li>- zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit.</li> </ul>	<p>parauniversitar” i ndryshuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.</li> <li>-Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022 “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> <li>- Udhëzimi nr. 16, datë 28.07.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.</li> <li>- Urdhër Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”.</li> <li>- Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> </ul>
---	--

## FUSHA: PROGRAME LËNDORE

<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të matematikës në shkollë”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i matematikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij;</li> <li>- përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim;</li> <li>- përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit;</li> <li>- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program;</li> <li>- gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxisin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre;</li> <li>- harton rezultate të nxëni për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me kompetencat e programit;</li> <li>- tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të matematikës);</li> <li>- shpjegon lidhjen program-tekst nxënësi;</li> <li>- përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Korniza Kurrikulare, 2014.</li> <li>- Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014.</li> <li>- Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016.</li> <li>- Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, klasat VI-IX dhe klasa X -</li> </ul>

<p>të realizuar përmbushjen e kompetencave;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- siguron informacion që demonstroi lidhjen e matematikës me shkencat e tjera dhe me jetën reale.</li> </ul>	
---	--

## FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE

<p><b>Kompetenca I</b></p> <p><b>“Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e matematikës”</b></p>	<p><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i matematikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij;</li> <li>- përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve;</li> <li>- demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit;</li> <li>- identifikoi nxënësit me nevoja të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë, nxënësit e talentuar etj.);</li> <li>- planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevoja të veçanta;</li> <li>- demonstroi qëndrim pozitiv ndaj shkencës dhe lëndës së matematikës;</li> <li>- edukoi të nxënësit dashurinë dhe kërkshërinë ndaj lëndës së matematikës;</li> <li>- motivoi nxënësit duke e konsideruar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015.</li> <li>- Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017</li> <li>- Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016.</li> <li>- Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, ASCAP (ish IZHA) 2018.</li> <li>- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së matematikës në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018.</li> <li>- Udhëzuesi për zhvillimin e lëndës së matematikës në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018.</li> </ul>



<p>motivimin një nga çelësat e progresit të tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- krijon klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit;</li> <li>- punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit.</li> </ul>	
<p style="text-align: center;"><b>Kompetenca II</b></p> <p style="text-align: center;"><b>“Përdorimi i metodave dhe i strategjive efektive në mësimdhënien e matematikës”</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i matematikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e rezultateve të nxënësit;</li> <li>- përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve;</li> <li>- planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin;</li> <li>- përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve;</li> <li>- përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen;</li> <li>- zhvillon kompetencat matematikore në mësimdhënien - nxënien e matematikës;</li> <li>- demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit;</li> <li>- shpjegon parimet e hartimit të një testi.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA, 2016.</li> <li>- Udhëzues për kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz, IZHA 2018.</li> <li>- Vlerësimi i nxënësit në arsimin e mesëm të ulët dhe në arsimin e mesëm të lartë. (<i>Material shpjegues në ndihmë të shkollave</i>), shtator 2019.</li> <li>- Udhëzuesi kurrikular lëndor në matematikë në arsimin e mesëm të ulët, dhjetor 2018.</li> <li>- Udhëzuesi kurrikular lëndor në matematikë në arsimin e mesëm të lartë, dhjetor 2018.</li> <li>- Modele testesh për arsimin parauniversitar (Teste të hartuara nga mësuesit), Lënda: matematikë.</li> <li>- Modele pyetjesh nga mësuesit për mësuesit, ASCAP 2021, Lënda: matematikë.</li> </ul>
<p style="text-align: center;"><b>Kompetenca III</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>

<p><b>“Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në matematikë”</b></p>	
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i matematikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- prezanton materiale matematikore duke përdorur teknologji të përshtatshme si: PowerPoint, Excel, MathType në Word;</li> <li>- nxit nxënësit të bëjnë prezantime në matematikë duke përdorur programe kompjuterike të njohura për ta;</li> <li>- gjen dhe përdor materiale nga website për të pasuruar dhe perfeksionuar mësimdhënie-nxënien;</li> <li>- përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së matematikës apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthuren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga website.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Urdhër për miratimin e “Standardeve profesionale të mësuesit për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit”, nr. 84 datë 06.05.2021.</li> <li>- Material ndihmës për mësuesit lidhur me përdorimin e platformave online në procesin mësimor, ASCAP 2021</li> <li>-</li> </ul>

## FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE TË KOMUNIKIMIT

<b>Kompetenca</b> <b>“Zbatimi i rregullave të etikës dhe të komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit”</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i matematikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njih rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin;</li> <li>- sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar.</li> <li>- Urdhër nr.46 datë 24.07.2020 “Për standardet profesionale të formimit të përgjithshëm dhe të formimit lëndor të mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar”.</li> </ul>

## FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

<b>Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe</b>	<b>Literatura e rekomanduar</b>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i matematikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- njih rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe;</li> <li>- demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.</li> </ul>

## FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

<p style="text-align: center;"><b>Kompetenca</b></p> <p style="text-align: center;"><b>“Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së matematikës”</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Literatura e rekomanduar</b></p>
<p><b>Rezultatet e pritshme</b></p> <p><i>Mësuesi i matematikës:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- dallon konceptet dhe shprehitë kryesore me të cilat operon lënda e matematikës në klasat 6-12;</li> <li>- përshkruan mënyrën e formimit të koncepteve matematikore në klasat 6-12;</li> <li>- përshkruan zhvillimin vertikal, nga njëri vit në tjetrin, të koncepteve dhe të shprehive;</li> <li>- dallon ndërvarësinë e koncepteve matematikore nga njëri - tjetri dhe lidhjen me konceptet e lëndëve të tjera;</li> <li>- zgjidh me saktësi dhe me mënyra të ndryshme situata problemore matematikore, të cilat përdorin konceptet dhe aftësitë e programeve të klasave 6-12;</li> <li>- mbledh informacion të saktë e bindës për nxënësit e tij rreth vlerave përdoruese të matematikës në shkencat tjera dhe në jetën e përditshme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Programe dhe tekste të lëndës së matematikës për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës për klasat VI-IX për arsimin e mesëm të ulët dhe X - XII për arsimin e mesëm të lartë.</li> </ul>

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË  
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



---

Rruga "Naim Frashëri"  
Nr. 37  
Tiranë  
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

*sekretaria@ascap.edu.al*

*www.ascap.edu.al*